



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:010596

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417184

P.nr.81/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit **B... F....**, nga fshati P..., Komuna e G..., për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Jeton Lakna, duke vepruar sipas propozimit të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Institucionit Shëndetësor, PP.II.nr.62/2024 të datës 09.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe jo publik, me datë 22.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.03.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit **B...F..**, nga i ati F..., e ëma I...e e lindur Sh..., i lindur më dt..... në Gjilan me vendbanim në fshatin Përlepnice, Komuna e Gjilanit, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

Eshtë fajtor

Sepse më 10.01.2024, rreth orës 15.00, në fshatin Përlepnice, Komuna Gjilan, në shtëpinë familjare, i pandehuri, për shkak të gjendjes së rënduar mendore dhe çrregullimeve psikike, ka shkaktuar dhunë në familje, ndaj babait të tij - Fazli Fazliu, viktimë e ndjeshme, në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligji për Dhunë në Familje, duke ushtruar dhunë psikike, ashtu që, i njëjti që dy muaj, vazhdimisht ka kërkuar nga prindi i tij, që ta largoj nga shtëpia thjeshtren e tij Zyrafete Fazliu, për shkak se të njëjtën nuk e dëshiron në shtëpi dhe duke kanosur se: „nëse kthehet Zyrafetja në shtëpi ka me u ba belaja, do të bahet gjaku deri në gju, nuk e dua, nëse don martohu me dikan tjetër, kurse kjo nuk guxon me ardhur se bahet belaja, ose dil me ta në banesë, çka të vyn kja në shtëpi, nuk ban thmi” edhe pse jetojnë që 18 vite së bashku, në të njëjtën shtëpi, për çka, Zyrafete Fazliu, nga frika të mos ndodh më e keqja është detyruar të largohet nga shtëpia dhe të shkoj tek prindërit e saj, me çka i pandehuri me veprimet e tij, tek i dëmtuari, pos që ka shkaktuar dhunë në familje, ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale Dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, në bazë të nenit 83, 84 dhe 86 të KPRK-së, si dhe nenit 514, paragrafi 3 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË LIRI

I. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri për të pandehurin Komuna e Gjilani, do të bëhet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dhe i njëjti do të zgjasë gjashtë (6) muaj.

II. OBLIGOHET i pandehuri që pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan, që t'i nënshtrohet trajtimit psikiatrik, sipas rregullave të caktuara nga mjeku përkatës psikiatrik.

III. Qendra e Shëndetit Mendor **ËSHTË E OBLIGUAR** që brenda periudhës dy (2) mujore, nga koha e fillimit të trajtimit ta njoftojë këtë Gjykatë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit të lartpërmendur.

IV. Në rast se i pandehuri, nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kjo Gjykatë, sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të institucionit të kujdesit shëndetësor do ta zëvendësojë këtë masë me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim.

V. I pandehuri ka qen nën masën e Paraburgimit me ndalim në Institutin Psikiatrik Forenzik në QKUK në Prishtinë prej 10.01.2024 deri më datën 22.02.2024.

VI. Aktvendimi duhet t'iu dorëzohet: Prokurorisë së shtetit, mbrojtësit të të pandehurit av. Jeton Lakna, të pandehurit, Institutit të Kujdesit Shëndetësor kompetent, shërbimit sprovues kompetent, Qendrës për Mirëqenie Sociale kompetente, sektorit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri dhe një kopje të ruhet për dosje.

VII. Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, Gjykata duhet të vendosë në bazë të nenit 516 të, KPP-së, mbi privimin nga zotësia për veprim, për tani të pandehurin e lartcekur. Lidhur me këtë vendim, duhet të njoftohet Qendra për Punë Sociale në Gjilan.

VIII. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Institutin Shëndetësor, PP.II.nr.62/2024 të datës 09.02.2024, kundër të pandehurit, nga f.sh Përlepnice, Komuna e

Gjilani, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të KPRK-ës.

Kjo gjykatë me datë 22.02.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin të ftuar prokurori i shtetit Flamur Ahmeti, i pandehuri, mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Jeton Lakna nga Gjilani dhe eksperti i psikiatrisë Dr. Afrim Cana nga Gjilani.

Eksperti i psikiatrisë Dr., fillimisht ka deklaruar lidhur me aftësinë e të pandehurit dhe se i njëjti është në gjendje që ta përcjell shqyrtimin gjyqësor dhe më pas ka mbetur në tërësi pranë ekspertizës, ka mbetur në tërësi pranë mendimit dhe konstatimit të dhënë si dhe ka deklaruar se mendoj që propozimi i masës së trajtimit të detyrueshëm në liri është adekuat për klientin e tij dhe kontribon në arritjen e një stabilizimit e gjendjes së tij mendore.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet pranë propozimit që e kanë parashtruar në Gjykatë lidhur me trajtimin e detyrueshëm në liri për të pandehurin, Besjan Fazliu si dhe nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë ndaj tij, si dhe e ka mbështet mendimin dhe konstatimin e mjekut Dr. Afrim Cana, andaj duke u bazuar në të gjitha këto o la propozuar Gjykatës të aprovoje këtë masë si të bazuar sepse konsideroj se për kohën dhe momentin është kohe adekuate, për shërimin dhe rehabilitim të tij.

I dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes ndaj djalit të tij dhe besoi se i njëjti është përmisuar dhe nuk dot kenë probleme mes veti .

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se në tërësi e pranoj propozimin e prokurorit të shtetit dhe mendimin e mjekut psikiatër Dr. Afrim Canës që pas konsultimit me ekspertin mjekoligjor të pandehurit të i shqiptohet masa e trajtimit psikiatrik në liri.

I pandehuri Besjan Fazliu e ka mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, tutje ka shtuar se është penduar për veprën e kryer, dhe ka premtuar që nuk do të kryej vepra të ngjashme dhe se do të kontrollohet vazhdimisht të mjeku.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykuar, pas dëgjimit të palëve, prokurorit të shtetit, ekspertës të psikiatrisë, mbrojtësit të të pandehurit, si dhe të pandehurit Besjan Fazliu, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë në gjendje që të deklarohet lidhur me pranimin apo mospranimin e fajësisë në këtë çështje penale, dhe e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykuar vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri, nga f.sh Përlepnice, Komuna e Gjilani, ka kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të masës

Gjyqtari i vetëm gjykuar, konform nenit 83, 84 dhe 86 të KPRK-së dhe nenit 514 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit

të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë, vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij.

Gjyqtari i vetëm gjykuese, me rastin e shqiptimit të masës ka marrë parasysh këto prova materiale të cilat janë bashkëngjitur në propozim si: Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2024- CA-0053, i datës 10.01.2024, deklarata e të dëmtuarit Fazli Fazliu, deklarata e dëshmitares Zyrafete Fazliu, deklarata e të pandehurit Besian Fazliu, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.807/17 i datës 25.08.2017, libreza e klientit nga shërbimi profesional i shëndetit mendor për të pandehurin, raportet mjekësor në emër të të pandehurit nga psikiatri Faton Kutllavci dhe Afrim Cana, forma bazike e të dhënave për viktimat e dhunës në familje, foto dokumentacioni, si dhe shkresa të tjera në lëndë.

Andaj gjykata pas dëgjimit dhe mendimit të palëve, në pajtim me nenin 86 paragrafi 1 nën paragrafët : 1.1; 1,2 dhe 1.3 të KPRK-së, konstatoi se:

- Ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë prapë vepër të ngjashme penale,
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për t'iu shmangur kryerjes së veprave penale të tjera, dhe
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Prandaj nga arsyet e theksuara si më lart, gjykata në pajtim me nenin 514 paragrafi 3 të KPPRK dhe lidhur me nenin 86 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se do të arrihet qëllimi i rehabilitimit psikiatrik i të pandehurit me paraqitje për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor, kështu që i pandehuri do të shmanget nga kryerja e veprave penale të çfarëdo natyre.

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues, kjo masë e shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura më lart është masë e drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, dhe se veprat penale të lartcekura i ka kryer duke mos pasur aftësi për të kuptuar rolin dhe rëndësinë e veprimeve të tij, dhe masa e shqiptuar nga ana e kësaj gjykate do të ndikojë tek ai që i njëjti të rehabilitohet dhe në të ardhmen të mos përsërisë vepër tjetër penale.

5.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata sa i përket kërkesës pasurore juridike nuk e ka udhëzuar të dëmtuarin pasi që i njëjti në seancën fillestare ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr. 81/2024
Më datë: 06.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Veli Kryeziu

Numri i lëndës: 2024:010596
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05417184

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate